



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 7453 /4937(31010-01143-86-2015)Rregj.Them.
Data Regjistrimi 06.03.2015

Nr. 86-2016-473 (2164)Vendimi
Datë 13.07.2016

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë prej :

GJYQTAR - Kastriot SELITA
GJYQTARE - Altina NASUFI
GJYQTARE - Bernina KONDI

Asistuar nga sekretare gjyqësore Valbona Zenelaj, në Tiranë, sot më datë 13.07.2016, shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë:

PADITËS: Shoqëria "UNIVERSAL" shpk, lagja Gurra Lezhë.

TË PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë.

Drejtoria e Apelimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

OBJEKTI: Shfuqizimin e aktit administrativ njoftim vlerësimi me nr. 3096/5 Prot. Datë 06.11.2013 nxjerr nga DRT Lezhë, lënë në fuqi me vendimin nr. 20546/3 Datë 05.02.2014 të DAT Tiranë dhe kthim përgjigjen me nr. 22003/3 Prot. Datë 14.04.2014.

BAZA LIGJORE: Neni 7 gërma "a", neni 15, neni 17 pika 1 gërma "a" ligji 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative" neni 75 pika 1, ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" udhëzimin nr. 2, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin nr. 650, datë 05.11.2014 ka vendosur :

1. *"Mos pranimin e padisë.*
2. *Shpenzimet gjyqësore sic janë bërë".*

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ka paraqitur ankim pala e paditëse në datën 10.11.2014.

Pala paditëse në ankimin e paraqitur prej saj ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke parashtuar se:

1. Meqenëse kundërshtohet njoftim vlerësimi i cili është shqyrtuar në rrugë administrative që ka marrë fund me dt 14.04.2014 pala paditëse është njoftuar me dt. 15.4.2014 dhe padie është dorëzuar me dt. 21.05.2014 ka kaluar ky afat i vendosur në ligj.
2. Jemi përpara një njoftimi të bërë nga ana e palës së paditur nëpërmjet postës jo në formën e kërkuar nga ligji pasi në rastin e vendimeve të marra nga pala e paditur duhet në mënyrë taksative të lajmërohet administratori i shoqërisë që i drejtohet vendimi. Në rastin konkret njoftimi është marrë nga një punonjës Vladimir Prendi, i cili nuk ka vënë në dijeni administratorin dhe ky person e ka lënë njoftimin në sirtarin e tij dhe duke harruar t'ja dorëzoi administratorit të shoqërisë. Gjate kësaj periudhe administratorit Ilir Nikaj ka lëvizur jashtë vendit në Itali për arsye shëndetësore.
3. Nga ana tjetër njoftimi i ardhur me postë dhe i harruar i është vënë në dijeni me datë 11.05.2014 kur administratori i kthyer nga Italia sikurse e vërteton edhe vula në pasaportën e tij, në këto kushte ka ngritur padinë në gjykatë me datën 21.05.2014. Nisur nga sa u tha më lart mendojmë se ndonëse pala e paditur ka paraqitur një dëftese postare për të treguar fillimin e afatit të ngritjes së padisë, në fakt kjo dëftese postare nuk është firmosur nga administratori i shoqërisë apo të paktën nga një person i afërt që ka kontakt me të.
4. Në këto kushte besojmë se shoqëria është në afatin e ngritjes së padisë pasi nuk provohet nga pala e paditur data e fillimit të afatit, pra data e njoftimit të administratorit të shoqërisë.

Sa më sipër pala paditëse ndryshimin e vendimit të mospranimit të Gjykatës Administrative Shkodër nga mospranim në pranim dhe vazhdimin e gjykimit të çështjes në këtë gjykatë.

Gjykata Administrative e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi, dëgjoi relacionin e përgatitur nga gjyqtari relator, si dhe analizoi shkaqet e ngritura në ankim, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 49/2012, në këndvështrim me kërkesat e ligjit material dhe procedural,

VËREN

Pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër në datën 27.05.2014 me kërkesë padi duke kërkuar:

Shfuqizimin e aktit administrativ njoftim vlerësimi me nr. 3096/5 Prot. Datë 06.11.2013 nxjerr nga DRT Lezhë, lënë në fuqi me vendimin nr. 20546/3 Datë 05.02.2014 të DAT Tiranë dhe kthim përgjigjen me nr. 22003/3 Prot. Datë 14.04.2014.

Pala paditëse në lidhje me këto kërtime ka referuar si bazë ligjore në nenet 7 gërma "a", neni 15, neni 17 pika 1 gërma "a" ligji 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative" neni 75 pika 1, ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" udhëzimin nr. 2, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin nr. 650, datë 05.11.2014 ka vendosur: Mospranimin e padisë.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ka paraqitur ankim pala e paditëse shoqëria "Universal" shpk brenda afatit ligjor.

Në këto rrethana gjykata e shqyrtoi çështjen administrative të paraqitur nëpërmjet këtij ankimi në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 49/1 të ligjit nr. 49/2012.

Rrethanat e çështjes

Nga aktet e dosjes gjyqësore të përcjella me ankimin kundër vendimit nr. 650, datë 05.11.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër rezulton se:

Pala e paditur DRT Lezhë ka ushtruar kontroll pranë palës paditëse dhe bazuar në këtë kontroll ka nxjerrë aktin njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 3096/5 Prot. Datë 06.11.2013 duke e ngarkuar palën paditëse me detyrime tatimore dhe duke e dënuar me gjobat përkatëse sipas detyrimeve tatimore.

Pala paditëse ndaj këtij akti ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Drejtoria e Apelimit Tatimor (DAT) me shkresën nr. 20546/1, datë 06.01.2014 i ka kërkuar palës paditëse të plotësojë dokumentacionin, ndër të tjera dhe dokumentin që vërteton pagesën e detyrimeve dhe interesave, kopje të aktit të apeluar (njoftim vlerësimi) dhe kopje të raport kontrollit të mbajtur.

Në vijim Drejtoria e Apelimit Tatimor (DAT) me vendimin e saj me nr. 20546/3 Prot. Datë 05.02.2014 ka vendosur: Refuzimin e Ankimit, pasi mungon dokumentacioni që vërteton pagesën e detyrimeve të përcaktuara në njoftim vlerësimin nr. 3096/5 Prot. Datë 06.11.2013 objekt apelimi.

Nuk rezulton nga aktet e dosjes se ky vendim i është njoftuar palës paditëse nga DAT Tiranë apo DRT Lezhë.

Shoqëria paditëse i është drejtuar përsëri me kërkesë DAT Tiranë në lidhje me njoftim vlerësimin e DRT Lezhë. (fq. 15 e fashikullit gjyqësor).

Nga ana e DAT-së është dërguar një shkresë tjetër shoqërisë Universal "Shpk me nr. 22003/3 Prot. Datë 4.04.2014 që konfirmon se – Ankimi i shoqërisë paditëse ndaj aktit njoftim vlerësimi nr. 3096/5 Prot. Datë 06.11.2013, për shumën 3.908.854 leke, nuk merret në shqyrtim, pasi DAT është shprehur një herë me vendimin e saj me nr. 20546/3 Prot. Datë 05.02.2014.

Kjo shkresë i është komunikuar me shërbim postare shoqërisë paditëse me datë 15.04.2014, marrë nga punonjësi i saj Vladimir Prendi.

Në këto kushte pala paditëse i është drejtuar në datën 27.05.2014 Gjykatës së Administrative të Shkallës së Parë Shkodër me kërkesë padinë me objekt, palë të paditura dhe bazë ligjore siç përshkruhet në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Shkodër në përfundim të gjykimit të çështjes me vendimin nr. 650, datë 05.11.2014 ka vendosur: Mospranimin e padisë.

Nga përmbajtja e vendimit nr. 650, datë 05.11.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër rezulton se:

1. Nga aktet e paraqitura nga palët në seancën përgatitore, rezultoi se kerkimi në gjykatë për: Shfuqizimin e aktit administrativ njoftim vlerësimi me nr. 3096/5 prot. dt. 06.11.2013 nxjerrë nga DRT Lezhë, lënë në fuqi me vendimin nr. 20546/3 dt.05.02.2014 të DAT Tiranë dhe kthim përgjigjen me nr.prot. 22003/3 dt.14.04.2014 është jashtë afatit 30 ditor të paraqitjes së kërkesë padisë bazuar në nenit 18 /1,7 të ligjit 49/2014.
 2. Bazuar në nenin 109 të ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në RSH" edhe sikur të merrej në konsideratë shkresa e fundit kthim përgjigje me nr. prot. 22003/3 dt. 14.04.2014, përsëri padia është paraqitur jashtë afatit të parashikuar në ligj.
- Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër kanë bërë ankim pala paditëse për shkaqet e paraqitura në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Gjykata Administrative e Apelit e shqyrtoi ankimin në dhomë këshillimi duke analizuar tërësinë e rrethanave faktike në referim të përcaktimeve të ligjit të zbatueshëm në rastin konkret.

Vlerësimi i gjykatës

Në analizë të ankimit dhe shkaqeve të ngritura nëpërmjet tij, të akteve të dosjes, të vendimit objekt ankimi si dhe në referim të përcaktimeve të ligjit procedural që gjen zbatim në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit çmon se: Vendimi nr. 650, datë 05.11.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është rrjedhim i një procesi të zhvilluar në respektim të dispozitave të ligjit procedural dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Pala paditëse në ankimin e ngritur prej saj parashtroi se: "njoftimi të bërë nga ana e palës se paditur nëpërmjet postës është jo në formën e kërkuar nga ligji pasi në rastin e vendimeve të marra nga pala e paditur duhet në mënyrë taksative të lajmërohet administratori i shoqërisë që i drejtohet vendimi. Në rastin konkret njoftimi është marrë nga një punonjësi i quajtur Vladimir Prendi, i cili nuk ka vënë në dijeni administratorin dhe ky person e ka lënë njoftimin në sirtarin e tij dhe duke harruar t'ja dorëzoi administratorit të shoqërisë".

Në lidhje me këtë pretendim Gjykata i referohet përcaktimeve të nenit 23 të ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në RSH" që përcakton se:

"Administrata tatimore mund të kërkojë përdorimin nga tatimpaguesit të formularëve të veçantë, për dorëzimin e dokumentacionit, informacionit apo kërkesave. Kur nuk kërkohet formular, çdo komunikim, i kërkuar sipas legjislacionit tatimor, dërgohet në mënyrë elektronike ose dorëzohet me shkrim, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

2. Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare të administratës tatimore, drejtuar tatimpaguesit, i njoftohen atij duke ia dërguar në adresën e deklaruar nga vetë ai:

- a) në rrugë elektronike, në përputhje me legjislacionin e komunikimeve elektronike dhe kur tatimpaguesi ka dhënë pëlqimin për pranimin e njoftimit në rrugë elektronike ose;*
- b) nëpërmjet shërbimit postar rekomandë..."*

Në rastin konkret pala paditëse në ankimin e saj pohon se e ka marrë aktin administrativ që kundërshton nëpërmjet shërbimit postar, por për shkak të neglizhencës (harresës) së një punonjësi të saj nuk është vënë në dijeni për këtë akt administratori i shoqërisë, për pasojë ka humbur afatin e paraqitjes së padisë në Gjykatë.

Administrata tatimore bazuar në dispozitën e sipërcituar ka detyrimin ligjor të njoftojë subjektin tatimpagues në lidhje me *vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare të administratës tatimore*. Këtë njoftim administrata tatimore e bën në adresën e deklaruar nga subjekti tatimpagues pranë organeve tatimore. Në rastin konkret DRT Lezhë dhe DAT kanë zbatuar këtë detyrim ligjor duke i komunikuar vendimmarrjen e tyre në adresën e palës paditëse gjë që provohet nga aktet e dosjes dhe pohimet e palës paditëse. Nëpërmjet kësaj adrese pala paditëse ka marrë dijeni sipas përcaktimeve të ligjit në lidhje me komunikimin e akteve. Shoqëria paditëse ka përgjegjësinë për menaxhimin e korrespondencës së saj në funksion të aktivitetit tregtar që kryen dhe të njoftojë në organet e shoqërisë në lidhje me këtë korrespondencë. Ligji nuk parashikon njoftim nominal për organet e shoqërisë në lidhje me aktet e shkresat e administratës tatimore, siç pretendon pala paditëse në ankimin e ngritur prej saj.

Në i. ethanat kur pala paditëse shkresën e DAT e ka marrë nëpërmjet shërbimit postar, dhe komunikimi është bërë konform kërkesave të ligjit, Gjykata çmon se ky pretendim i palës së paditur është i pabazuar në ligj e në prova dhe si i tillë është i papranueshëm.

Gjykata çmon se, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në rastin konkret kërkimi i palës paditëse për: Shfuqizimin e aktit administrativ njoftim vlerësimi me nr. 3096/5 Prot. Datë 06.11.2013 nxjerrë nga DRT Lezhë, lënë në fuqi me vendimin nr. 20546/, datë 05.02.2014 të DAT Tiranë dhe kthim përgjigjen me nr. 22003/3, datë 14.04.2014 është jashtë afatit 30 ditor të paraqitjes së kërkesë padisë bazuar në nenit 18 /1,7 të ligjit 49/2014.

Referuar shkaqeve të ngritura në ankim nga pala paditëse, kjo Gjykatë çmon se ato, janë të pa mbështetura në ligj dhe nuk janë të tilla që mund të çenojnë vendimin e shkallës së parë. Pala paditëse nuk ka ngritur ndonjë shkak thelbësor që ka të bëjë me zgjidhjen në themel të çështjes dhe njëkohësisht shkaqet e ngritura nuk i referohen ndonjë shkeljeje procedurale që passjellin cënimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Sa më sipër, pretendimet e parashtruara nga pala e paditëse në Gjykatën Administrative të Apelit për kundërshtimin e vendimit nr. 650, datë 05.11.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër janë të pabazuara në ligj dhe në prova dhe si të tilla të papranueshme.

Në rrethanat e përshkruara sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërma "b" të ligjit Nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", çmon se vendimi nr. 650, datë 05.11.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50 gërma "b" të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"*,

VENDOSI :

1. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 650, datë 05.11.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
2. Shpenzime gjyqësore nuk ka.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot më datë 13.07.2016.

GJYQTAR
Bernina KONDI
d.v

GJYQTAR
Altina NASUFI
d.v

GJYQTAR
Kastriot SELITA
d.v

Vertetohet njesia me origjinalin